



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 124
Prishtinë, më 6 shtator 2010
Salla e mbledhjeve plenare

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 6, 7 dhe 8 SHTATOR 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Deputeti **Mahir Yagcilar** në emër të Grupit Parlamentar “7+”, kërkoi që pika nr. 13 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër.

Ministrja **Edita Tahiri**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se nuk e mbështet propozimin e deputetit Yagcilar.

Kryesuesi kërkoi nga Kuvendi deklarim për propozimin e deputetit Mahir Yagcilar.

Kuvendi nuk e miratoi propozimin e deputetit Mahir Yagcilar për ta shtyrë shqyrtimin Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore,
5. Propozimi i Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e guvernatorit të BQK-së,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ish- të burgosurit politikë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,
19. Shqyrtimi i Raportit të dytë të progresit për Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
20. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2009,
21. Propozimi i Grupit Parlamentar “7+” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: Riza Smaka, Ismajl Kurteshi, Myrvete Pantina, Besa Gaxherri, Ardian Gjini, Sabri Hamiti, Zafir Berisha, Nait Hasani, Rita Hajzeraj dhe Naser Rugova, që janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 15, 22, 23 dhe 27 korrik 2010

Procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 15, 22, 23 dhe 27 korrik 2010, u miratuan pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Abdyl Ymeri**, parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me atë se a ka ministria që ai e drejton strategji apo plane të veprimt të cilat do ta rregullonin çështjen e menaxhimit të ujësjellësve në tërë Kosovën.

Ministri **Mahir Yagcilar**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Abdyl Ymeri.

Deputeti **Bujar Dugolli**, parashtroi pyetje për ministrin, Lutfi Zharku, lidhur me zhvendosjen e ndërtimit të Institutit të Ndërtimit dhe të Institutit të Industrisë, nga Parku i Biznesit në Drenas në lokacionin e Bërnicës, komuna e Prishtinës.

Ministri **Lutfi Zharku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bujar Dugolli.

Deputetja **Gjylnaze Syl**a, parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me nënshkrimin e kontratës para se të bëhet sigurimi i mjeteve financiare për ndërtimin e autostradës Morinë – Merdarë.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Gjylnaze Syl

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me vlerësimin e aseteve të PTK-së nga këshilltarët e transaksionit dhe për çfarë çmimi pret Qeveria që PTK të shitet.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Driton Tali.

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me atë se a ka Qeveria ndonjë plan për të vendosur rendin dhe rregullin nëpërmjet Administratës Tatimore në fushën e bastoreve sportive.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Driton Tali.

Deputetja **Drita Maliqi**, parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me masat që do të ndërmarrë Qeveria për ndalimin e rritjes së çmimeve të konsumit, për uljen e shkallës së varfërisë dhe për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike në vend.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Drita Maliqi.

Deputeti **Naim Rustemi**, parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me respektimin apo jo të kodit të etikës nga ana e bordeve të drejtorëve nëpër kompanitë publike qendrore.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Naim Rustemi.

Deputeti **Naim Rustemi**, lexoi pyetjen e parashtruar për ministren, Justina Shiroka - Pula, por për shkak të mosprezencës së ministres, ai nuk mori përgjigje.

Deputetja **Rita Hajzeraj-Beqaj**, lexoi pyetjen e parashtruar për kryeministrin, Hashim Thaçi, por kryeministri nuk ishte i pranishëm.

4. Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore

Kryesuesi, pasi konstatoi se nuk kishte kuorum të nevojshëm për shqyrtimin e kësaj pike, atë e shtyri për mbledhjen e ardhshme plenare.

5. Propozimi i Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e guvernatorit të BQK-së

Kryesuesi tha se kërkesa e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është parashtruar në bazë të Ligjit të vjetër, ndërsa kërkesa duhet të riprocedohet sipas ligjit në fuqi.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Ministri **Bajram Rexhepi**, tha se Projektligji për Inspektoratin Policor të Kosovës përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Në vazhdim, tha se objekt i veprimtarisë së Inspektoratit Policor të Kosovës është parandalimi, dokumentimi dhe zbulimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e policisë së Kosovës, hetimi i incidenteve disiplinore, ku përfshihen të gjithë punonjësit e policisë, përveç drejtorit të policisë.

Më tej, ai vuri në pah se misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është synimi i sigurimit të një shërbimi policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Në fund, theksoi se ky projektligj është hartuar në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë nga kjo fushë dhe kërkoi miratimin, në parim, të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviq, si dhe deputetët: Sanije Aliaj, Riza Smaka, Gani Koci dhe Shkumbin Demaliaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----6,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejtë të mundshëm nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Ministri **Lutfi Zharku**, tha se Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike rregullon veprimtarinë e institucioneve shtetërore në fushën e eksportit-importit, transitit të mallrave strategjike, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve të cilat marrin pjesë në lëmin e biznesit nga kjo fushë.

Në vazhdim, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, miraton vendimin për përpilimin e listës së mallrave dhe të shërbimeve strategjike në pajtim me listën e mallrave strategjike të Bashkësisë Evropiane, ndërsa procedurën e lëshimit të lejes për eksportin e këtyre mallrave e bën MPB-ja.

Projektligji parasheh masat ndëshkuese për shkeljet që mund të bëhen, tha ai.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha - Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar "7+" , Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vladimir Todoroviç, si dhe deputetët: Riza Smaka, Gani Buçinca, Bujar Dugolli, Naim Maloku dhe Lulzim Zeneli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,

Kundër-----12,

Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete,

Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për mbrojtjen e natyrës.

Në emër të Qeverisë, Projektligjin e paraqiti ministri **Lutfi Zharku**, i cili tha se deri më tani kjo fushë është rregulluar me Rregullore të UNMIK-ut. Projektligji të cilin po e shqyrtojmë sot është i harmonizuar me standardet e legjislacionit të BE-së dhe rregullon çështjet që kanë të bëjnë me florën, faunën, mbrojtjen e natyrës dhe vendosjen e masave ndëshkuese për shkeljet e ndryshme, tha ai.

Në vazhdim, ai tha se në përpilimin e këtij Projektligji janë marrë parasysh edhe përvojat legjislative të Sllovenisë dhe të Kroacisë.

Në fund, ai shprehu bindjen se ky projektligj do të jetë në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtjen e natyrës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Hëset Cakolli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Xhezair Murati, si dhe deputetët: Naim Rrustemi, Gjylnaze Sylja, Riza Smaka dhe Lulzim Zeneli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,

Kundër-----0,

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e natyrës

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejtë të mundshëm nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ish- të burgosurit politikë

Kryesuesi ftoi deputetin Hydajet Hyseni që në emër të grupit të deputetëve dhe në cilësinë e propozuesit, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për ish- të burgosurit politikë.

Deputeti **Hydajet Hyseni**, tha se nevoja për Projektligjin për ish- të burgosurit politikë është shumë e madhe, por në një mënyrë është edhe e vonuar nga se shumë veteranë të lëvizjes kombëtare kanë ndërruar jetë, pa pasur rastin që një ditë t'i gëzojnë frytet e aktivitetit të tyre.

Në vazhdim, tha se ky projektligj është hartuar nga Shoqata e të Burgosurve Politikë, në bashkëpunim me Shoqatën e Juristëve të Kosovës, faktorin ndërkombëtarë në Kosovë dhe ngërthen në vete praktikën më të mira të vendeve të rajonit.

Më tej, theksoi se gjatë fazës së hartimit të këtij projektligji janë marrë në konsideratë mundësitë financiare të kufizuara të shtetit të Kosovës, së këndejmi ky projektligj nuk do të ketë implikime të mëdha buxhetore.

Në fund, ai tha se gjatë fazës së shqyrtimit në komisionet parlamentare projektligji do të amendamentohet në ato pika ku mund të ketë ndonjë mangësi dhe ftoi deputetët për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ish- të burgosurit politikë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Bahri Hyseni, Mimoza Ahmetaj, Ibrahim Gashi, Riza Smaka, Driton Tali, Bujar Dugolli, Gani Buçinca, Sala Berisha – Shala, Hajdin Abazi dhe Hydajet Hyseni, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----77,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ish- të burgosurit politikë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në vazhdim, kryesuesi propozoi që pika nr. 11 dhe nr. 12 e rendit të ditës të shtyhen për ditën e nesërme, ndërsa në mbledhjen e sotme të shqyrtohen pika nr. 10 dhe pika nr. 13 e rendit të ditës.

Kuvendi miratoi propozimin e kryesuesit.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, ose raportuesin e komisionit, që në emër të këtij komisioni dhe në cilësinë e propozuesit ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

Deputetja **Synavere Rysha**, tha se Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin, i hartuar nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, ka për qëllim krijimin e medias së pavarur, rritjen e tregut konkurrent dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara në fushën e mediave elektronike – radiove dhe televizioneve, si dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave në pajtim me standardet më të mira evropiane. Në vazhdim, tha se gjatë fazës së përpilimit të këtij projektligji, grupi punues ka mbajtur edhe dëgjime publike në praninë e ekspertëve të fushës, ndërsa për shkak të zbatueshmërisë më të mirë të ligjit, grupi punues ka vendosur të shkohet me projektligj të ri, e jo me plotësim ndryshim të ligjit ekzistues.

Më tej, theksoi se ky projektligj nuk i cenon aktet juridike të legjislacionit të BE-së nga kjo fushë, kurse qasja e publikut në dokumentacionin e Komisionit të Pavarur të Mediave i përgjigjet praktikave më të mira evropiane.

Ky projektligj nuk do të ketë implikime buxhetore shtesë, por vetëm ato të parapara me buxhetin e vendit për vitin 2010 dhe ftoi deputetët për miratim, në parim, të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Abdyl Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, si dhe deputeti Naim Rustemi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin prej dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Ministrja **Edita Tahiri** tha se regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave paraqitet si nevojë e domosdoshme dhe prioritare e Republikës së Kosovës për shumë qëllime dhe analiza në fusha të ndryshme të shoqërisë sonë.

Në vazhdim, ajo tha se regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave do të bëhet nga data 1 – 15 prill 2011, në pajtim me standardet e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare.

Më tej, tha se projektligji cakton mënyrën e organizimit, të formimit, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të cilat e bëjnë regjistrimin, procedurat për publikimin dhe masat që do të ndërmerren për shkelje të këtij ligji dhe, marrë në tërësi, do të jetë një investim afatgjatë për sistemin statistikor të vendit.

Në fund, ministrja tha se ky projektligj është në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe kërkoi miratimin, në parim, të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Melihate Termkolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Ibrahim Makolli, Mark Krasniqi, Bujar Dugolli, Riza Smaka dhe ministrja Edita Tahiri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen në orën 17:40 minuta, për të vazhduar nesër.

E martë, 7 shtator 2010
Vazhdim i mbledhjes plenare

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare.

Kryetari tha se Kuvendi i vazhdon punimet me shqyrtimin e parë të Projektligjit për prokurimin publik.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për prokurimin publik.

Ministri **Ahmet Shala** tha se Projektligji për prokurimin publik ka për qëllim të ngritë efikasitetin dhe transparencën lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të fondeve publike dhe të gjitha burimeve tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim ai tha se ky projektligj rregullon përgjegjësitë e zyrtarëve publik, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë të përfshirë në një aktivitet prokurimi, duke kërkuar nga ata vendime të bazuara në ligj dhe të mos ndikohen nga interesat e ndryshme.

Më tej tha se nëpërmjet këtij projektligji synohet krijimi i një kulture sa më profesionale duke respektuar parimin e shfrytëzimit efikas, të drejtë, të fondeve dhe burimeve publike dhe arsyeshmërinë e kostos ekonomike.

Në fund ministri kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për prokurimin publik.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sllobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Arsim Bajrami, Berim Ramosaj, Naim Rustemi, Rexhep Hoti, Bujar Dugolli, Gani Koci, Myzejene Selmani, Driton Tali, Zef Morina dhe Hajdin Abazi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----49,

Kundër-----4,

Abstenime-----10.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim, Projektligjin për prokurimin publik.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropiane dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në

afatin sa më të shpejtë të mundshëm nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre.

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** tha se Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe familjeve të tyre, është më se i nevojshëm për trajtimin që shteti i Kosovës u bën kategorive të përcaktuara në këtë projektligj.

Në vazhdim ai tha se qëllimi i projektligjit është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilët dhanë kontribut vendimtar për çlirimin e Kosovës.

Këto kategori të përcaktuara në projektligj janë: dëshmorët, të zhdukurit, invalidët, veteranët, pjesëtarët e UÇK-së dhe anëtarët e familjeve të tyre si dhe kategoria tjetër, ajo e viktimave civile të luftës, invalidët civilë të luftës dhe familjet e marra peng dhe të zhdukurit civilë të luftës, tha ai.

Në fund zëvendëskryeministri Kuçi kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Adem Hajdaraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj- Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliç si dhe deputetët: Melihate Termkolli, Zafir Berisha, Shkumbin Demaliaj, Gani Geci, Armend Zemaj, Jakup Krasniqi, Ibrahim Gashi, Emrush Xhemajli, Naser Rugova, Xhavit Haliti, Teuta Hadri, Mimoza Ahmetaj, Arsim Bajrami, Sanije Aliaj, Ismail Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, Hajdin Abazi, Riza Smaka, Gani Buçinca, Esat Brajshori, Luljeta Shehu, Driton Tali, Naim Rustemi, Lulzim Zeneli, Besa Gaxherri, Sabri Hamiti dhe Ismet Beqiri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Kuvendi me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si komisione funksionale dhe raportuese, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

E mërkurë, 8 shtator 2010

Vazhdim i mbledhjes plenare

Kryetari tha se Kuvendi i vazhdon punimet me shqyrtimin e parë të Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Ministri **Haki Demolli** tha se ky projektligj është rezultat i punës së vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë drejt përmbushjes së strategjisë legjislative nga kjo fushë.

Në vazhdim ai tha se ky projektligj ka për qëllim sigurimin e kthimit të shpejtë të fëmijës që mbahet pa të drejtë në shtetin e vendqëndrimit, si dhe krijimin e mekanizmave për sigurimin dhe respektimin e të drejtës së kujdestarisë dhe të kontaktit me fëmijë. Më tej tha se ky projektligj rregullon edhe procedurat që duhet zbatuar në rastet e rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Projektligji për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve është përgatitur në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar në Kosovë, të fushës përkatëse, dhe është në harmoni me Konventën e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, të vitit 1980.

Deri më tani kjo fushë të ne ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2004/29.

Në fund ministri tha se ky projektligj është në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe kërkoj miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së,

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sllobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Armend Zemaj dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është mjaft e madhe ngase deri më tani nuk kemi pasur një ligj adekuat i cili do ta rregullonte këtë veprimtari ekonomike, në vendin tonë.

Në hartimin e këtij projektligji – drafti i parë, kanë marrë pjesë ekspertët vendorë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Projektligji të cilin po e shqyrtojmë sot ka për qëllim rregullimin e çështjes së prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimin e duhanit të papërpunuar dhe produkteve të tij në Republikën e Kosovës.

Më tej tha se ky projektligj përcakton të drejtat dhe detyrat e subjekteve të cilat merren me prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Në fund ministri kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Kaqusha Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Heset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser

Rugova, në emër të Grupit Parlamentar”7+”, Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Nurishahe Hula, Suzan Novoberdaliu, Hydajet Hyseni, Riza Smaka, Xhavit Haliti, Bujar Dugolli, Armend Zemaj dhe Lulzim Zeneli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër-----10,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për dizajnin industrial.

Ministri **Lutfi Zharku** tha se ky projektligj është hartuar në vazhdimësinë e ndërtimit të një sistemi efikas të pronësisë intelektuale dhe të asaj industriale. Në këtë drejtim ligji aktual ka pasur disa mangësi të cilat jemi munduar t’i eliminojmë në këtë projektligj.

Në vazhdim tha se projektligji përcakton kushtet për mbrojtjen e dizajnit industrial, fitimin, dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat e regjistrimit etj.

Më tej tha se ky projektligj ka të bëjë me të gjitha dizajnet industriale të cilat i nënshtrohen procedurës së regjistrimit në Zyrën për Pronësi Industriale, të cilat vlejnë në Republikën e Kosovës.

Në fund ministri tha se ky projektligj është në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për dizajnin industrial.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar”7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sllobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Nerxhivane Dauti dhe Riza Smaka, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për dizajnin industrial.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin më të shpejt të mundshëm nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për markat tregtare.

Ministri **Lutfi Zharku** tha se ky projektligj përcakton rregullat për mbrojtjen e markave tregtare, mënyrën e fitimit të së drejtës së markës tregtare, procedurat e regjistrimit, ndërprerjen e vlefshmërisë dhe anulimin e markave tregtare.

Në vazhdim tha se projektligji të cilin po e shqyrtojmë sot përmban dispozita të harmonizuara me direktivat e BE-së nga kjo fushë.

Më tej tha se ky projektligj është një nga prioritetet i cili ndërlidhet me Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për markat tregtare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetja Nerxhivane Dauti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për markat tregtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport, dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin më të shpejt të mundshëm nga shqyrtimi i parë Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi** tha se Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, ka për qëllim rregullimin e procedurave për akreditimin e stafit të huaj diplomatik në Republikën e Kosovës, siç janë takimet zyrtare të shefit të misionit diplomatik, atasheut ushtarak, konsullit etj.

Në vazhdim ai tha se Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës është hartuar nga ekspertët vendorë dhe nga Zyra për Shërbime dhe Ndihmë Juridike.

Në fund zëvendëskryeministri kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Jashtme dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Hydajet Hyseni, Gjylnaze Sylja dhe Rexhep Hoti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----34,
Kundër-----25,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi, ngarkoi Komisionin për Punë të Jashtme si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

19. Shqyrtimi i Raportit të dytë të progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Kryesuesi, në fillim, tha se Komisioni funksional për Integritet Evropian, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka hartuar Raportin e dytë të progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010, dhe Kuvendit ia ka paraqitur, rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e tij në mbledhje plenare.

Deputetja **Zylfije Hundozi**, në emër të Komisionit funksional tha se Komisioni Evropian në vitin 2009 e tutje i ka intensifikuar veprimet e veta karshi Kosovës. Kosovës i është ofruar dialogu për vizat, pasi të jenë plotësuar kushtet e kërkuara nga Komisioni Evropian. Ajo në vazhdim tha se pas përsëritjes së numrit të veprimeve në Raportin e progresit, institucionet e Kosovës, e sidomos Kuvendi i Kosovës, i kanë marrë seriozisht dhe kanë intensifikuar punën për përmbushjen e atyre kriterëve.

Më tutje deputetja Hundozi potencoi se nga 85 sfida, janë përmbushur 35 sosh, për të vlerësuar se në 6 muajt e fundit është punuar më seriozisht në përmbushjen e këtyre sfidave.

Qeveria e Kosovës ka dërguar në Kuvend Projektligjin për prokurimin publik, i cili duhet të miratohet sa më parë, konstatoi ajo, ndërsa vlerësoi se kriteret e karakterit ekonomik kërkojnë përkushtim më të madh për t'u përmbushur.

Në fund ajo i paraqiti edhe rekomandimet që dalin nga Raporti i dytë i progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010, dhe kërkoi miratimin nga ana e Kuvendit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Njomza Emini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Myrvete Pantina, Gani Koci, Drita Kadriu, Safete Hadergjonaj, Branislav Grbiç, Rexhep Hoti, Bahri Hyseni dhe Zylfije Hundozi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- -3,
Abstenime----- -2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Raportin e dytë të progresit për planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

20. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2009

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, kanë shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2009 dhe Kuvendit ia kanë paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtimin dhe miratimin e tij në mbledhje plenare.

Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit funksional që ta arsyetojë raportin para deputetëve.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci** tha se ky komision ka shqyrtuar Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2009, dhe ka rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Deputetja **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion tha se ky komision, lidhur me politikën zhvillimore dhe fondet bankare ka paraqitur rekomandimet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Ajo në vijim i lexoi tri rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slllobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Rexhep Hoti, Naim Rustemi dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 17,
Kundër-----26,
Abstenime----- 16.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Raportin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2009.

21. Propozimi i Grupit Parlamentar “7+” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi konstatoi se Grupi Parlamentar “7+” e ka tërhequr kërkesën për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:18 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale